



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

MENAXHIMI I RISKUT

SIGURUESHMËRIA DHE MADHËSIA E RISKUT

Kapitulli 3

Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku

Ph.D. Fisnik Morina



MARS, 2018





MENAXHIMI I RISKUT

2

- Lënda: Menaxhimi i Riskut
- Viti III-të, Semestri VI, Departamenti: KF
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënes: Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: ibish.mazreku@unhz.eu
fisnik.morina@unhz.eu





SIGURUESHMËRIA DHE MADHESIA E RISKUT



- Nga aspekti i teorisë së sigurimeve dhe të teorisë së riskut, risku i cili mund të sigurohet është rrezikshmëri nga veprimi i riskut të pasigurtë, të rastësishëm, të veprimit të dëmshëm të riskut të siguruar në objektin e sigurimit në periudhën e ardhshme kohore.



SIGURUESHMËRIA E RISKUT



4

- Që një risk të mund të sigurohet ai duhet ti kënaq kriteret në vijim:
 1. Risku, me realizimin e të cilit ndodhë humbja apo dëmtimi i objektit të siguruar duhet të jetë i mundur dhe i pasigurtë nga vullneti i të siguruarit apo personit tjetër të interesuar.
 2. Shprehja/ndodhja e riskut të siguruar duhet të jetë ngjarje e ardhshme dhe e pasigurtë. Kjo do të thotë se risku i cili e shkakton këtë dëm nuk guxon të jetë diçka që sigurisht do të ndodhë, sepse ligji i numrave të mëdhenjë bazohet në ndodhjen e rastësishme të ngjarjes së dëmshme.



SIGURUESHMËRIA E RISKUT



- Humbja apo dëmi që e shkakton ai risk duhet të jetë plotësisht e përcaktuar, duhet të përcaktohet shkaku i ndodhjes së riskut, vlera e tij financiare, koha dhe vendi, kur dhe ku ka ndodhur humbja. Me fjalë të tjera duhet të jetë në mundësi që të vërtetohet saktë se kur ka ndodhur dëmi dhe të vërtetohet ndonjë vlerë e tij.
- Risku duhet të jetë homogjene. Me rastin e marrjes së riskut në sigurim dhe formimit të portofoliosë së saj, siguruesi duhet të siguroi sa më shumë risqe të siguruarave të njëjtën apo me karakteristika të njëjta (frekuenca dhe intensiteti), respektivisht me elemente përafërsisht të njëjtë për tarifim.



SIGURUESHMËRIA E RISKUT



6

- Risku duhet të jetë i shpërndarë ne kohe dhe hapësire, çka do të thotë se numri i ngjarjeve të rrezikshme të realizuara duhet të jetë i vogël ne raport me të gjitha risqet e siguruara ne hapsiren e caktuar dhe ne kohën e caktuar.
- Pasojat e shprehura të risqeve duhet të jenë të qasshme për evidencë statistikore.
- Nëse strukturën e portfolios se siguruesit e përbejnë numër i mjaftueshëm, numër minimal i risqeve të ngjashme apo të njëjlojshme, të cilët shprehen me frekuencën dhe intensitetin e caktuar, siguruesi ka mundësi të krijoj statistikën me rëndësi për efikasitetin e portfolios se tij.



SIGURUESHMËRIA E RISKUT



- Ngjarja e rrezikshme duhet të jetë e lejuar sipas ligjit dhe moralit dhe të kuptimit të përgjithshëm shoqërorë. Siguria ekonomike dhe juridike kërkojnë përcaktimin e qartë të rreziqeve të cilat duhet mballuar me sigurim.
- Dëmi i cili është pasojë e riskut duhet të jetë aq qe duhet të ketë pasoja ekonomike për të siguruarin.
- Nëse sigurohen pozicione vlera e të cilave nuk është e lartë, e veçanërisht kur frekuenca e dëmeve është e madhe, premia mund të jetë e barabartë apo me e madhe se dëmi i mundshëm, qe e bene sigurimin të panevojshëm.



Karakteristikat e riskut të sigurueshem





SIGURUESHMËRIA E RISKUT



- Ekzistojnë më shumë faktorë që e kufizojnë sigurueshmërinë e riskut, nga të cilët më të rëndësishmit janë:
 1. Lartësia e premisë shtesë e cila është shprehje e shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve të kapitalit të siguruesit. Marre në përgjithësi, sa më e lartë të jetë shtesa mbulesa që e ofron sigurimi do të jetë më e vogël.
 2. Hazardi psikologjik apo pakujdesi për shkak të ekzistimit të sigurimit në kuptim të uljes së kujdesit të të siguruarit për të ndërmarrë masa mbrojtëse.
 3. Seleksionimi negativ në rastet kur pronarët e policave janë më mirë të informuar se siguruesi mbi lartësinë e mundshme të kërkesave për zhdëmtim.



MADHËSIA E RISKUT



- Para se të merret risku në sigurim është e domosdoshme të caktojmë madhësinë e tij e cila e përbënë bazën për llogaritjen e premisë se sigurimit.
- Ekzistojnë shumë akterë të cilët ndikojnë në burime të rreziqeve dhe në vetë riskun.
- Në kuptimin më të gjerë burimet e riskut i përbëjnë para se gjithash rrethina natyrore, shoqërore-politike, si dhe rrethina punuese-ekonomike.



MADHËSIA E RISKUT



- Faktorët që e definojnë riskun, e të cilët duhet analizuar në mënyrë detale, parasegjithash janë:
- **Objekti i sigurimit** me karakteristikat e veta fizike-teknike dhe karakteristikat tjera (jeta, lloji i veprimtarisë, struktura e ndërtimit, llojet e teknologjike dhe instalimeve etj.).
- **Rreziku prej të cilit sigurohet** (si p.sh zjarri, thyerja, sëmundja, vdekja etj.),
- **Vlera e objektit të sigurimit** (shuma e sigurimit, respektivisht shuma e siguruar), dhe mënyra e mbrojtjes siguroese, do të thotë shuma dhe vëllimi i detyrimit të marrur.



MADHËSIA E RISKUT



- Pozicioni, respektivisht lokacioni i objektit të sigurimit,
- Zgjatja e sigurimit,
- Sistemi i masave preventive të mbrojtjes,
- Frekuenca dhe intensiteti i dëmeve të ndodhura,
- Dëmi maksimal i mundshëm, respektivisht dëmi i mundshëm, si dhe faktorët tjerë.



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



- Bazën nismëtare për vlerësimin e probabilitetit të realizimit të rrezikut e përbënë analiza gjithëpërfshirëse e riskut, e cila bazohet në përcaktimin e kornizës fillestare të cilët e karakterizojnë nga afër.
- Ashtu si risku në thelbin e tij nënkupton pasigurinë dhe humbjen , sjellja e këtyre dy karakteristikave të riskut në kornizën analitike, mundëson bazat nismëtare për analizën e tij.



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



14

- Risku është rreziku potencial i humbjes së ndonjë gjëje që ka vlerë, ndërsa vlerësimi i riskut, është procedura e njohjes dhe analizimit të rrezikshmërisë me përcaktimin e pasojave dhe probabilitetit të humbjes.
- Kjo do të thotë se risku përmban si probabilitetin e ngjarjes, ashtu edhe pasojën e pritur të ngjarjes dhe numerikisht është i barabartë me produktin e tyre.



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



15

- Gjatë analizës së riskut, si komponentë të parë të rëndësishme, teoria e riskut e ka pranuar frekuencën e riskut, sepse mu ajo paraqet shpeshtësinë e ngjarjeve të padëshirueshme – të shprehjes së riskut, në periudhën e kohës së vrojtimit.
- Në raste se ndonjë risk ndodh (realizohet) shpesh në periudhën e kohës vrojtuese, frekuenca e tij është e madhe dhe e kundërta.



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



16

- Do të thotë se shpeshtësia respektivisht frekuenca e riskut (f_R) paraqet numrin e përsëritjes së realizimit të riskut të njëjtë (numrin e dëmeve në periudhën vrojtuese) në raport me numrin e përgjithshëm të objektëve të siguruara (numrin e sigurimeve) dhe më së shpeshti tregohet në përqindje, ashtu që është:

$$f_R = \frac{\sum N_D}{\sum Z_{OS}} \times 100 [\%]$$

f_R = frekuenca e riskut

$\sum N_D$ = numri i përgjithshëm i objektëve të dëmtuara të sigurimit, respektivisht numri i përgjithshëm i dëmeve.

$\sum Z_{OS}$ = numri i përgjithshëm i objektëve të siguruara, respektivisht numri i sigurimeve.



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



- Varësisht nga frekuenca e riskut kemi risqe të rralla, pak të mundshme, mesatarisht të mundshme, shumë të mundshme dhe risqe gati të sigurta. Në tabelën II – 4 jepen llojet e rrisqeve sipas shpeshtësisë së tyre.

LLOJI I RISKUT	SHPESHTËSIA E REALIZIMIT TË NGJARJES SE DEMSHME (%)
Risqet e rralla	1 – 3
Risqet pak të mundshme	3 – 10
Risku i mundshëm i moderuar	10 -20
Risku shumë i mundshëm	20 -66
Risku gati i sigurt	66 – 100



- Me masat preventive të sheteve dhe organizatave siguruese është e mundur të ndikohet në zvogëlimin e frekuencës së dëmeve, si dhe në intensitetin e tyre.
- Në tabelën II – 5 janë prezantuar efektet e zbatimit të dhunës së policisë së trafikut në pjesën e një rruge në periudhën 2000 – 2003.

Personat që kanë pësuar	Para futjes së masave			Pas futjes së masave			DALLIMI	
	GJITHSEJ						7/4 (+,-)	7/ 4 (%)
	2000	2001	(2+3)	2002	2003	5+6		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
Personat të vdekur	34	58	92	24	14	38	-54	-58,70
Persona të lënduar rëndë	85	93	178	50	56	106	-72	-40,45
Persona të lënduar lehtë	138	192	330	87	104	191	-139	-42,12
Gjithsej persona që kanë pësuar	257	343	600	161	174	335	-265	-44,17



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



19

- Komponentë e dytë e riskut – humbja apo dëmi , definohet me madhësinë e dëmit ekonomik (financiare) e cila ndodhë me realizimin e rrezikut.
- Në këtë kuptim në teorinë e riskut është aprovuar nocioni intensiteti i riskut. Intensiteti i riskut është me i madh në rast se madhësia e dëmit ekonomik të pritur e shkaktuar me ndodhjen e ngjarjes së rrezikshme është më i madh dhe e kundërta.



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



Kjo do të thotë se intensiteti i dëmit (I_D) paraqet përqindjen e dëmtimit të objektit të siguruar dhe është i barabartë:

$$I = \frac{\sum I_{os}}{\sum S_{os}} \times 100 [\%]$$

I = intensiteti i dëmeve,

$\sum I_s$ = shuma e përgjithshme e dëmeve,

$\sum S_{os}$ = shuma e përgjithshme e sigurimit të objekteve të dëmtuara.



FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



- Nga këndvështrimi i sigurimeve intensiteti i riskut varet nga lloji i rrezikut, karakteristikave fizike-teknike të objektit të sigurimit, vlerës së objektit të sigurimit, lartësisë së detyrimit të marrë, afatit të sigurimit, vendit ku gjendet objekti i sigurimit etj.
- Pasi që risku është rreziku potencial i humbjes të diçkaje që ka vlerë, kurse vlerësimi i riskut është procedurë e njohjes dhe analizës së rrezikut të cilat janë karakteristike e ngjarjeve të ndryshme, si dhe përcaktimi i pasojave dhe probabilitetit të humbjes, kështu që me definimin e frekuencës dhe intensitetit të riskut plotësisht definohet edhe vetë risku.



- Të vështrojmë nga njëra anë elektranat nukleare, të të cilat për shkak të llojit të vetë paisjeve dhe aplikimit të masave të sigurisë tekniko-teknologjike është shumë e vogël mundësia e ndodhjes së ngjarjeve të padëshirueshme, mirëpo pasojat janë shkatërrimtarë.
- Deri më tani vetëm një fatkeqësi është klasifikuar si fatkeqësi e madhe nukleare, e ky ka qenë ngjarja e Qernobilit ne vitin 1986.
- Eksplozioni i cili e ka bartur në ajër reaktorin e plotë të IV, ka lënë pasoja të rënda afatgjatë (mbi 30.000 të vdekur).





FREKUENCA DHE INTENZITETI I DËMIT



23

- Në anën tjetër, ta vështrojmë ndërtesën moderne të ndërtesës afariste – qendër tregtare, e cila në strukturën e saj ka mjaft sipërfaqe prej qelqi dhe ku rrjedha e njerëzve është e madhe.
- Nëse në këtë rast e vështrojmë riskun e thyerjes së xhamave, mund gjithashtu të konstatojmë se ai është i madh. Konstatimi se risku është i madh në këtë rast e argumenton fakti se është i madh probabiliteti i thyerjes së xhamave, respektivisht është e lartë frekuenca e realizimit të riskut.
- Dëmi ekonomik e shkaktuar nga me thyerjen individuale të xhamave sigurisht se nuk është aq e madhe ashtu që në bazë të asaj ta karakterizojmë riskun si të madhe.



- Mirëpo ekzistojnë rastet të cilët nënkuptojnë frekuencën e madhe dhe intensitetin e madh, respektivisht frekuencë të vogël dhe intensitet të vogël, si është rasti p.sh në komunikacionin ajrorë, dëmet të cilat lumërohen këtu gjatë fatkeqësive individuale (rënia e fluturakës) kryesisht janë totale, si nga aspekti ekonomik, ashtu edhe nga aspekti i jetës së njerëzve.
- Nëse gjatë kësaj rritet frekuenca e këtyre dëmeve, është e sigurtë se në mënyrë proporcionale rriten edhe humbjet ekonomike respektivisht intensiteti i riskut.

Foto II - 11




Foto II - 12





Foto II-13



Ju Faleminderit për vëmendje !

26

□ SUKSESE !

